



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-02/DPK
 Nr. Prot. 01-1683/16
 Br. Prot. 01-1683/16
 Prot No. 01-1683/16
 Nr. i faq. 02
 Data 05-05-2016
 Broj stranica 02
 Datum 05-05-2016
 Nr. pages 02
 Date 05-05-2016

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.05.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3957/15, për z. Hajrullah Sallova – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3957/15, për z. Hajrullah Sallova – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesin privat “Habena”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Sallova është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë ka ardhur në takim në zyrat e AKK-së dhe është njoftuar me faktet që posedon Agjencia në lidhje me këtë situatë. Ndërkohë, Agjencia kundër korrupsionit nuk ka marr informatë për shmangien e kësaj gjendje, konform ligjit, dhe rekomandimeve që i ishin bërë z. Sallova, dhe ndërkohë ka konstatuar se, zyrtari i lartë, nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme, për të shmangur situatën me konflikti interesi në ushtrimin e funksionit publik.

Më pas AKK i ka bërë zyrtarit të lartë edhe shkresën e dytë që quhet “Paralajmërim” në të cilën e njofton atë për situatën në të cilën ndodhet, për masat tjera që mund të pasojnë, nëse gjendja nuk ndryshon dhe njëkohësisht i jep afat të ri, por, të kufizuar ligjor, për ta ndryshuar këtë gjendje duke shmangur konfliktin e interesit.

Ndërkohë Zyrtari i lartë z. Hajrullah Sallova, ka dërguar në Agjenci informatat mbi biznesin privat, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ai ka hequr dorë nga funksioni i bashkëpronësisë në biznesin privat. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

